



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

DEKLARAT PËR SHTYP

Prezantimi I Raportit Vjetor për Vitin 2019

Kryetari I ERE-s mori pjesë në seancën dëgjimore për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në drejtimin e kryetarit Z. Niko Peleshi, e organizuar me Videokonferencë më datë 20.05.2020. Z. Petrit Ahmeti raportoi mbi veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë, lidhur me sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, për vitin 2019. Deputetët u prezantuan dhe me vështirësitë e arritjet me të cilat janë përballur këta sektorë.

Z. Ahmeti si fillim përshëndeti njoftimin se "Grupi Rajonal I Evropës Kontinentale" votoi më 20.04.2020 marrëveshjen e re të Lidhjes midis "Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës" (KOSTT) dhe "Operatorët Evropian të Sistemit të Energjisë Elektrike" (ENTSO-E). Kjo është një arritje tejet e rëndësishme jo vetëm për Operatorin e Sistemit të Energjisë Elektrike të Kosovës por dhe për krijimin e një zone rregulluese të përbashkët midis të dy vendeve apo dhe hapat e mëtejshëm të krijimit të një tregu të përbashkët midis Shqipërisë dhe Kosovës, ku Operatorët e Sistemit të Operimit janë aktorët kryesorë.

Raportimi vjetor I ERE-s lidhur me Sektorin e Energjisë vlerëson se ka patur një qëndrueshmëri për sa i takon aktivitetit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mbajtur dhe ruajtur parametra të qëndrueshëm operimi. Z. Ahmeti vuri në dukje se viti 2019 shënoi një situatë jo të mirë hidrike, duke u pasqyruar me një ulje e prodhimit të energjisë elektrike.

“Prodhimi i përgjithshëm i vendit ka qënë në nivelin 5.2 TWh, me një ulje prej rreth 40% krahasuar me vitin 2018, i cili duhet thënë se ka qënë një vit me prodhimin më të madh të realizuar që nga viti 1985. Ndërkohë që importi i energjisë elektrike ka qënë në vlerat 2.4 TWh. Gati 57% e këtij prodhimi është prodhuar nga Shoqëria Publike e gjenerimit, pjesa tjetër prej 43% është prodhuar nga centralet private konçesionare ose jo. Humbjet në sistemin e shpërndarjes së Energjisë Elektrike kanë qënë në nivelin 21.79%, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar me vlerën prej 23.96% të vitit 2018. Përgjatë vitit 2019 është vënë re gjithashtu një rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaik”, detajoi Kryetari I ERE-s.

Në Sektorin e gazit natyror, Z. Ahmeti vlerëson se janë shënuar zhvillime efikase në strukturimin dhe funksionimin normal të tij, ku ecuria e investimit të projektit TAP luan një rol të rëndësishëm.

Ndër të tjera për Vitin 2020, Enti Rregullator I Energjisë do të fokusohet në çështjet që lidhen me:

- i. Miratimi dhe zbatimi i Rregullores së Transparencës dhe Integritetit të Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT),
- ii. Monitorimi i implementimit të ndarjes funksionale dhe organizative të OSHEE,
- iii. Zbatimi i planit strategjik për reformat në Sektorin Elektroenergjetik,
- iv. Impakti i Burimeve të Rinovueshme në treg,
- v. Miratimi dhe zbatimi i strategjisë për infrastrukturat kritike në Sektorin e Energjisë, (vi) Paketa e Energjisë së Pastër,
- vi. Zbatimi i mekanizmit të Tregut të Balancimit dhe garantimi i shërbimeve ndihmëse,
- vii. Platforma Online e Krahasimit të Çmimeve të Furnizuesve,
- viii. Vijimi i punës për krijimin e Tregut të Përbashkët të Energjise Elektrike me Kosovën dhe në rajon,
- ix. Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të Energjisë Elektrike dhe krijimi i Bursës së Energjisë,
- x. Krijimi i Tregut të Garancive të Origjinës,
- xi. Studimi i zgjidhjeve dhe përgatitja e propozimeve përkatëse për shuarjen e detyrimeve reciproke.

Në fund të raportimit vjetor, Z. Ahmeti falenderoi Bordin dhe të gjithë stafin e ERE-s si dhe të gjitha Insitucionet përkatëse për mbështetjen dhe bashkëpunimin; në menyrë të veçantë Kuvendin e Shqipërisë por edhe konsumatorët shqiptarë , të cilët në çdo rast kanë patur akses të sigurt në praktikat e shqyrtuara dhe miratuara nga ana e ERE-s edhe përgjatë këtyre kohëve të vështira për të gjithë shoqërinë Shqipëtare. Duke mos haruar pa përmendur dhe shoqatat për mbrojtjen e konsumatorit si dhe bashkëpunimin konstant me Autoritetin e Konkurrencës, kryetari i ERE-s shprehu bindjen për vazhdimin e këtij bashkëpunimi të frytshëm edhe në të ardhmen.